

Duatë hapëse të Namazit – Shejkh Abdur-Razzak el-Bedër

Burimi: **Kitabudh-dhikri ued-du'aai**

(Duaja 1)

اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ، اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنْ خَطَايَايَ كَمَا يُنَقَّى الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ، اللَّهُمَّ اغْسِلْنِي مِنَ خَطَايَايَ بِالتَّلْجِ وَالْمَاءِ وَالْبَرَدِ

Allahumme ba`id bejnii ue bejne khataajaaje kema ba`adte bejnel-meshriki uel-magrib, Allahumme nek-kinii min khataajaaje kema junek-kaa eth-theubul-ebjadu mined-denes, Allahumme-gsilnii min khataajaaje bith-thelxhi uel-maai uel-bered

“O Allah, më largo mua prej gjunaheve ashtu siç ke larguar lindjen nga perëndimi. O Allah, më pastro mua nga gjunahet e mia, ashtu siç pastrohët rroba e bardhë prej papastërtisë. O Allah, m’i pastro mua gjunahet me borë, me ujë dhe me breshër.”¹

(Duaja 2)

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، وَتَبَارَكَ اسْمُكَ، وَتَعَالَى جَدُّكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ

SubhaneKe Allahumme ue bihamdiKe, ue tebaareke-smuKe, ue te`aala xhed-duKe, ue la ilahe gajruKe

¹ Transmeton Ebu Hurejrah – radijAllahu anhu – i cili thotë: I Dërguari i Allahut – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – pasi thoshte tekbinin fillestar të namazit rrinte në heshtje për pak kohë para se të fillonte leximin e Sures, prandaj i thashë: O i Dërguari i Allahut, me të vërtetë që të dua më shumë se babanë dhe nënën time, çfarë thua gjatë heshtjes mes tekbitit fillestar dhe fillimit të leximit? Ai – sal-IAllahu ue sel-lem tha –: **“Them: “O Allah, më largo mua prej gjunaheve ashtu siç ke larguar ...”** [Transmeton Bukhari 744, Muslimi 598 me tekst të tij]

“I Pastër nga të metat je o Allah, Ty të takon Lavdia dhe falenderimet, i Madhërishëm është Emri Yt, e Lartësuar është Madhëria Jote, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje.”²

(Duaja 3)

وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ، إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ، لَا شَرِيكَ لَهُ وَبِذَلِكَ أُمِرْتُ وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمِينَ، اللَّهُمَّ أَنْتَ الْمَلِكُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، أَنْتَ رَبِّي وَأَنَا عَبْدُكَ ظَلَمْتُ نَفْسِي وَاعْتَرَفْتُ بِذُنُوبِي فَاعْفُرْ لِي ذُنُوبِي جَمِيعًا إِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ، وَاهْدِنِي لِأَحْسَنِ الْأَخْلَاقِ لَا يَهْدِي لِأَحْسَنِهَا إِلَّا أَنْتَ، وَاصْرِفْ عَنِّي سَيِّئَهَا لَا يَصْرِفُ عَنِّي سَيِّئَهَا إِلَّا أَنْتَ، لَبَّيْكَ وَسَعْدَيْكَ وَالْخَيْرُ كُلُّهُ فِي يَدَيْكَ وَالشَّرُّ لَيْسَ إِلَيْكَ، أَنَا بِكَ وَإِلَيْكَ تَبَارَكْتَ وَتَعَالَيْتَ، أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ

Uexhehtu uexh'hii lil-ledhii fetaras-semauati uel-erd, hanijfen ue ma ene minel-mushrikijn. Inne salaatii ue nusukii ue mahjaaje ue memaatii lil-Lahi Rabbil-`aalemijn, la sherijke leHu ue bidhalike umirtu ue ene minel-muslimijn. Allahumme Entel-Meliku la ilahe il-la Ente, Ente Rabbii ue ene `abduKe dhalemte nefsii u`a-teraftu bidhenbii feg-fir lii dhunuubii xhemij`an, innehu la jegfirudh-dhunuube il-la Ente, ueh-dinii li-ahsenil-akhlaaki la jehdi li-ahseniha il-la Ente, ues-rif `annii sej-jieha la jesrifu `annii sej-jieha il-la Ente. LebejKe ue s`adejKe uel-khajru kul-luhu fii jedejKe uesh-sherr-rru lejse ilejK, ene biKe ue ilejK, tebaarekte ue te`aalej, estagfiruKe ue etuubu ilejK

“Ia drejtova me sinqeritet veprat, adhurimet dhe Fenë time Atij që ka krijuar qiejt dhe tokën, duke qenë në besimin e pastër Islam (hanif) dhe unë nuk jam prej idhujtarëve. Me të vërtetë që adhurimi im, kurhani im dhe çdo vepër e mirë që bëj

² Transmeton Aisheh – radijAllahu anha –, e cila thotë: I Dërguari i Allahut – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – thoshte në lutjen hapëse të namazit: **“I Pastër nga të metat je o Allah, Ty të takon Lavdia dhe falenderimet ...”** [Transmeton Ebu Daudi 776, Muslimi 339 nga Umer ibn Khattab i cili e thoshte këtë lutje]

dhe vdes me të, janë për Allahun, Zotin e gjithësisë, i Cili është i Pashok. Pikërisht për këtë gjë jam urdhëruar nga Allahu, dhe unë jam prej Muslimanëve (të nënshtruarve ndaj Allahut). O Allah, Ti je Sunduesi i gjithçkaje, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje. Ti je Zoti im dhe unë jam robi Yt. Pa dyshim që i kam bërë padrejtësi vetes sime (duke mëkatuar), i pranoj mëkatet e mia andaj m’i fal të gjitha mëkatet e mia, me të vërtetë që askush nuk mund t’i fal mëkatet përveç Teje. Më udhëzo mua në moralet më të larta, askush nuk mund të më udhëzojë në to përveç Teje. Më largo mua nga morali i keq, askush nuk mund të më largojë prej tij përveç Teje. Të përgjigjem në çdo kohë dhe jam i lumtur që jam gjithmonë nën bindjen Tënde! E gjithë mirësia është në Dorën Tënde, dhe me vepra të këqija njeriu nuk afrohet te Ty! Kërkoj Mbrojtjen Tënde, dhe te Ty do të kthehem. I Madhëruar e i Lartësuar je Ti, kërkoj faljen Tënde dhe te Ty pendohem!”³

(Duaja 4)

اللَّهُمَّ رَبَّ جِبْرَائِيلَ وَمِيكَائِيلَ وَإِسْرَافِيلَ فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ عَالِمَ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ أَنْتَ تَحْكُمُ
بَيْنَ عِبَادِكَ فِيمَا كَانُوا فِيهِ يَخْتَلِفُونَ اهْدِنِي لِمَا اخْتَلَفَ فِيهِ مِنَ الْحَقِّ بِإِذْنِكَ إِنَّكَ تَهْدِي مَنْ تَشَاءُ
إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

Allahumme Rabbe Xhibraiiile ue Mikaiile ue Israafiile, Faatiris-semauati uel-erd,
`Aalimel-gajbi uesh-shehaadeh, Ente tehkumu bejne `ibadiKe fijma kanuu fijhi
jekhtelifuun, ihdiniilima-khtulife fijhi minel-hakki bi-idhniKe, inneKe tehdiil men
teshaau ilaa siratin mustekijm

“O Allah, Zoti i Xhebrailit, Mikailit dhe Israfil! Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Ti je Ai që di të fshehtën dhe të dukshmen! Ti do t’i gjykosh robërit e Tu për atë që janë

³ Transmeton Ali ibn Ebi Talib – radijAllahu anhu – se i Dërguari i Allahut – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – kur fillonte të fal namaz thoshte: “Ia drejtova me sinqeritet veprat adhurimet dhe Fenë time Atij që ka krijuar qiejt dhe tokën ...” [Transmeton Muslimi 771]

kundërshtuar, andaj me Lejen Tënde më udhëzo mua në rrugën Tënde të drejtë!
Pa dyshim që Ti e udhëzon atë që dëshiron prej robërve të Tu në rrugën Tënde të drejtë.”⁴

(Duaja 5)

اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ قَيِّمُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ نُورُ السَّمَوَاتِ
وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ مَلِكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ، وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ
الْحَقُّ، وَوَعْدُكَ الْحَقُّ، وَقَوْلُكَ الْحَقُّ، وَلِقَاؤُكَ الْحَقُّ، وَالْجَنَّةُ الْحَقُّ، وَالنَّارُ الْحَقُّ، وَالنَّبِيُّونَ الْحَقُّ، وَمُحَمَّدٌ
صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ حَقُّ، وَالسَّاعَةُ حَقُّ، اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ،
وَإِلَيْكَ أُنَبِّتُ، وَبِكَ خَاصَمْتُ، وَإِلَيْكَ حَاكَمْتُ، فَاعْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ وَمَا أَخَّرْتُ، وَمَا أَسْرَرْتُ
وَمَا أَعْلَنْتُ، أَنْتَ الْمُقَدِّمُ وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ

Allahumme leKel-hamdu Ente Kajjimusi-semauati uel-erdi ue men fijhinne, ue leKel-hamdu Ente Nuurus-semauati uel-erdi ue men fijhinne, ue leKel-hamdu Ente Melikus-semauati uel-erdi ue men fijhinne, ue leKel-hamdu Entel-Hakk, ue u`aduKel-hakk, ue kauluKel-hakk, ue likaauKe hakk, uel-Xhennetu hakk, uen-Naaru hakk, uen-Nebijjuune hakk, ue Muhammedun sal-IAllahu alejhi ue sel-lem hakk, ues-Sa`atu hakk. Allahumme leKe es`lemtu, ue biKe aamentu, ue `alejKe teuek-keltu, ue ilejKe enebtu, ue biKe khaasemt, ue ilejKe haakemt, fe-gfir lii maa kad-demt ue maa akh-khartu, ue maa es`rertu ue maa e`alentu, Entel-Mukaddimu ue Entel-Muekh-khiru, la ilahe il-la Ente

“O Allah, Ty të takon Lavdia dhe falenderimet. Ti je Mbajtësi i qiejve dhe i tokës dhe çfarë ka në to. Ty të takon e gjithë Lavdia, Ti je Ndriçuesi i qiejve dhe i tokës dhe çfarë ka në to. Ty të takon e gjithë Lavdia, Ti je Sunduesi i qiejve dhe i tokës

⁴ Transmeton Aisheh – radijAllahu anha –, e cila thotë: I Dërguari i Allahut – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – kur u falte natën, e hapte namazin e tij me këtë lutje: **“O Allah, Zoti i Xhebrailit, Mikailit dhe Israfil! Krijuesi i qiejve dhe i tokës ...”** [Transmeton Muslimi 770]

dhe çfarë ka në to. Ty të takon e gjithë Lavdia, Ti je el-Hakk (Ai që ekziston përgjithmonë dhe që meriton të adhurohet). Premtimi Yt (për besimtarët) është i vërtetë, Fjala Jote është e vërtetë e pamohueshme, takimi me Ty (Ditën e Gjykimit) do të ndodhë vërtetë, Xhenneti ekziston dhe është i vërtetë (është përgatitur për besimtarët), Xhehennemi ekziston dhe është i vërtetë (është përgatitur si dënim për mosbesimtarët), Pejgamberët janë të dërguar prej Teje, Muhammedi – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – është i Dërguari i vërtetë, dhe Dita e Gjykimit vërtetë që do të ndodhë. O Allah, Ty t’u nënshtrova dhe t’u binda, Ty të besova (për çdo gjë), Ty të jam mbështetur dhe ta kam dorëzuar veten time, te Ty u ktheva duke t’u bindur, me Ty mbrohem dhe argumentohem ndaj polemizuesve dhe të gjitha çështjet e mia i kthej te Ty për t’i gjykuar. Prandaj m’i fal mua të gjitha gjunahet, të mëhershme dhe të mëvonshme, të dukshmet dhe të fshehtat. Ti i ngre në grada disa prej robërve të tu sipër të tjerëve, dhe disa i ul poshtë të tjerëve. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje.”⁵

(Duaja 6)

اللَّهُ أَكْبَرُ كَبِيرًا، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ كَثِيرًا، وَسُبْحَانَ اللَّهِ بُكْرَةً وَأَصِيلًا

Allahu Ekber kebiira, uel-hamdu lil-Lahi kethiira, ue SubhanAllahi bukraten ue Esiila

“Allahu është më i Madhi, përmenda dhe madhërova më të Madhin. Lavdia dhe falenderimet e shumta i takojnë vetëm Allahut. I Pastër nga të metat është Allahu, në mëngjes dhe në mbrëmje (në çdo kohë).”⁶

⁵ Transmeton Ibn Abbasi – radijAllahu anhum –, i cili thotë: Pejgamberi – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – kur u ngrinte për të falur namazin e natës (tehexh-xhud) thoshte këtë lutje: “O Allah, Ty të takon Lavdia dhe falenderimet. Ti je Mbajtësi i qiejve dhe i tokës dhe çfarë ka në to ...” [Transmeton Bukhari 1120, 6317, 7385, 7442, 7499, Muslimi 769]

⁶ Transmeton Ebu Zubejr, nga ‘Aun ibn AbdiLah ibn ‘Utbeh, nga ibn ‘Umer –RadijAllahu anhum – i cili thotë: “Ndërkohë që ishim duke u falur me të Dërguarin e Allahut – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – njëri prej njerëzve tha: “Allahu është më i Madhi, përmenda dhe madhërova më të Madhin. Lavdia dhe falënderimet ...” I Dërguari i Allahut – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – tha: “Kush është ai që i tha këto fjalë?!” Një burrë prej njerëzve tha: Unë, o i Dërguari i Allahut. I Dërguari i Allahut – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – tha: “U mahnita prej tyre! U hapën dyert e qiellit për këto fjalë!” Ibn ‘Umeri tha: Nuk e kam lënë pa i thënë këto fjalë, që kur e dëgjova të Dërguarin e Allahut – sal-IAllahu alejhi ue sel-lem – të thotë ashtu!” [Sahih Muslim, 601]

Përktheu: Servet Mata